

# Mjedisi për Njerëzit në Harkun Dinarik




## Program Mjedisor, Bashkepunimi per Zhvillim ne Ballkanin Perendimor

Harku Dinarik në Europën Jug-Lindore është një zonë me trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore. Rajoni ka pyje të dendura e pothuaj të paprekura dhe popullata të shëndetshme të kafshëve të mëdha (arinj, rriqebuj, ujçër, caka) dhe është një nga zonat më të pasura me ujë në Mesdhe për sa i përket ekosistemeve me ujë të freskët. Megjithatë këto cilësi janë në kërcënim për shkak të krizës ekonomike aktuale dhe rrethanave shoqërore ekonomike të mëparshme. Efektet e braktisjes rurale dhe degradimit të mjedisit natyror kanë pasojë të rënda në kushtet e jetës të shumë popullsive rurale në rajon.

Megjithatë, ngjarjet më të fundit kanë krijuar një mundësi për të ruajtur diversitetin biologjik dhe kulturor të harkut Dinarik. Në Konferencën e 9-të të Palëve në Konventën e Diversitetit Biologjik (CBD COP 9) u miratua deklarata e "Fitores së Madhe", që i pruri qeveritë e Europës Jug-Lindore në vizionin e përbashkët të një rrjeti të madh nderkufitar të zonave të mbrojtura që shtrihen përgjatë këtij rajoni të rëndësishëm ekologjik. Ky angazhim i përbashkët do të ndihmojë në mbrojtjen e diversitetit të pasur kulturor dhe biologjik të rajonit, të favorizojë zhvillimin e ekonomive kombëtare dhe të krijojë baza konkrete për një bashkëpunim rajonal në të ardhmen.

Duke ndjekur angazhimet e ndërmarrë në Deklaratën e "Fitores së Madhe", si edhe në parimet e Iniciativës mbi Harkun e Alpeve Dinarike, një numër organizatash kanë bashkuar forcat për të krijuar projektin "Mjedisi për Njerëzit në Harkun Dinarik" i cili do të zbatohet për tre vjet, nga 2009 deri në 2012, dhe do të mbështesë bashkëpunimin ndër-kufitar për ruajtjen e objekteve kryesore natyrore dhe kulturore.

Duke mbuluar gjashtë vendndodhje pilot, (NP Plitvička jezera-NP Una, NP Durmitor-NP Sutjeska, NP Tara-Drina, Neretva delta, Mountain Dinara, dhe Prokletije / Bjeshkët e Namuna) projekti do të promovojë vlerat kulturore dhe natyrore të zonës, duke përmirësuar jetën e komuniteteve lokale nëpërmjet fuqizimit të bashkëpunimit rajonal dhe qeverisjes së mirë të mjedisit.



Bjeshkët e Namuna (Shqipëri), foto: Tomasz Pezold/IUCN



Bujqësia tradicionale ne fshatin Džajići (BH), foto: © WWF-Canon / E. Parker



Një larmi e gjerë veprimtarish do të ndërmerren në nivele të ndryshme, që përfshijnë:

- Ngritjen e partneriteteve private e publike, nga poshte lart, për të mbrojtur dhe përdorur trashëgiminë natyrore;
- Identifikimi i veprimeve në fushat e turizmit, pylltarisë, bujqësisë dhe mbrojtjes e zonave vecanërisht të vlefshme;
- Britjen e kapaciteteve për të njohur dhe vlerësuar biodiversitetin lokal dhe vlerat kulturore;
- Bashkërendimin e përpjesëtimeve për të ndërmarrë veprime të përbashkëta në të dy anët e kufijve;
- Vlerësimin e mundësisë për të krijuar zonat e mbrojtura ndërkufitare;
- Realizimin e aktiviteteve për ruajtjen e natyrës sipas modeleve Europiane; dhe
- Krijimin e platformave për të lehtësuar ndërveprimin dhe koordinimin midis vendim-marrësve të lartë të shteteve të ndryshme.

Projekti “Mjedisi për Njerëzit në Harkun Dinarik” (i njohur gjithashtu si “Mbështetje e Komuniteteve Rurale dhe Peisazheve të tyre Tradicionale përmes Përforsimit të Qeverisjes Mjedisore në zonat e Mbrojtura Ndërkufitare të Harkut Dinarik”) po zbatohet nga IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës), WWF MedPO (Program Mesdhetar për Fondin e Kafshëve të Egra), SNV (dhe Organizata e Hollandeze për Zhvillim). Dhe është një projekt bashkëpunimi për zhvillim dhe mjedisor në Ballkanin Perëndimor financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës.



Crni vir (BH)  
foto: © WWF-Canon / E. Parker

## Skuadra Menaxhuese:

### Veronika Ferdinandova

IUCN Zyra e Programit  
për Europën Jug-Lindore  
veronika.ferdinandova@iucn.org

### Jetona Myteveli

SNV Organizata Hollandeze për Zhvillim  
jmyteveli@snvworld.org

### Emira Mešanović

WWF Programi Mesdhetar  
emesanovic@wwf.panda.org



#### Dy fjalë për IUCN

IUCN, Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës, ndihmon botën të gjejë zgjidhje pragmatike për sfidat tona me të mprehta të zhvillimit dhe të mjedisit. IUCN punon në fushën e biodiversitetit, ndryshimeve klimaterike, energjisë, mjetet e jetesës së njerëzve dhe gjelbërimit të ekonomisë botërore duke mbështetur kërkimin shkencor, zbatimin e projekteve në terren në gjithë botën, dhe stimuluar bashkëpunimin mes Qeverive, OJQ-ve, OKB-së dhe kompanive për të hartuar politika, ligje dhe praktika më të mira.

IUCN është organizata mjedisore më e madhe dhe më e vjetër botërore, me më shumë se 1000 anëtarë, qeveri dhe OJQ dhe pothuajse 11,000 ekspertë vullnetarë në 160 vende. Puna e IUCN mbështetet nga një personel prej 1,000 vetësh në 60 zyra dhe qindra partnerë në sektorët privatë dhe publikë dhe OJQ në mbarë botën.

[www.iucn.org](http://www.iucn.org)



#### Dy fjalë për SNV

SNV është një nga organizatat më aktive në botë, me rreth gjysmë shekulli përvojë ndërkombëtare. Duke punuar në 33 vende, në katër kontinente, SNV kombinon frymëzimin e punonjësve për zhvillim dhe shërbimet këshilluese profesionale, fuqizon kapacitetet e organizatave lokale me qëllim që të ndikojë realisht në zhvillimin ekonomik rural.

Vizioni i SNV është një shoqëri ku të gjithë njerëzit gëzojnë lirinë për të arritur zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. SNV ofron shërbime profesionale me cilësi të lartë dhe njohuri për grupet dhe individët me qëllim që të kontribuojë në organizata të forta, të qëndrueshme dhe të suksesshme, si kushte paraprake që njerëzit dhe komunitetet të jenë të afta të zhvillohen.

Në Ballkanin Perëndimor, SNV ka qënë aktive për 15 vjet, duke punuar në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Përmes një rrjeti prej 11 zyrash në zona lokale, me mbi 100 punonjës si personel të përhershëm të SNV-së mbështesin një numër të madh organizatash private dhe të sektorit publik, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, duke zhvilluar ekonominë rurale dhe ndihmuar procesin e lokalizimit të BE-së në bujqësi, pylltari, turizëm, furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëqeverisje.

SNV, Organizata Hollandeze për Zhvillim me qendër në Hagë, e regjistruar si një fondacion i pavarur në Hollandë, merr ndihmën financiare kryesore nga Ministria Hollandeze e Punëve të Jashtme.  
[www.snvworld.org](http://www.snvworld.org)



#### Dy fjalë për WWF

WWF, organizata botërore e mbrojtjes mjedisore, është një organizatë e pavarur mjedisore për mbrojtjen e kafshëve, ndër më të mëdhatë dhe me të respektueshmet në botë. WWF ka një rrjet ndërkombëtar aktiv në më shumë se 100 vende me rreth 5 million mbështetës.

Misioni i WWF është të ndalojë degradimin e mjedisit natyror në tokë dhe të ndërtojë një të ardhme, në të cilën njerëzit të jetojnë në harmoni me natyrën, duke mbrojtur larinë biologjike të botës, dhe siguruar që përdorimi i burimeve natyrore të ripërtëritshme të jetë i qëndrueshëm, dhe promovon uljen e ndotjes dhe konsumit të mbeturinave. WWF njihet nga gërmat e para të saj kudo.

[www.panda.org/mediterranean/](http://www.panda.org/mediterranean/)